



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Durrës, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[26/05/2023]

Drejtuar: ASI-2A CO me NIPT K53002402C

Adresa: Fier Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Procedura e prokurimit/lotit: Hapur, Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-64546-04-01-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion Rruge Ne Nja Ishem”

Kohëzgjatja e kontratës: **21** (ditë)

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike 11 Prill Numri 32

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. K.M.K me NIPT L78223801E, me vlerë të ofertës 11’073’400 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind) lekë.
2. CAUSHI M me NIPT L88419801O, me vlerë të ofertës 12’244’340 (dymbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet) lekë.
3. S.M.O UNION me NIPT J66902042Q, me vlerë të ofertës 12’424’300 (dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e treqind) lekë.
4. EURONDERTIMI 2000 me NIPT K02003001O, me vlerë të ofertës 13’169’700 (trembëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë.
5. VARAKU E me NIPT J61902509S, me vlerë të ofertës 13’323’700 (trembëdhjetë milion e treqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind) lekë.
6. BONUS me NIPT K72412009E, me vlerë të ofertës 13’336’390 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.
7. SARK me NIPT K52531415H, me vlerë të ofertës 13’808’277 (trembëdhjetë milion e tetëqind e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.
8. ASI-2A CO me NIPT K53002402C, me vlerë të ofertës 14’751’950 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.
9. BEQIRI me NIPT J98624801V, me vlerë të ofertës 15’537’600 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë.

10. DENIS-05 me NIPT K51518029B, me vlerë të ofertës 19'052'750 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

-Për ofertuesin **K.M.K me NIPT L78223801E**, me vlerë të ofertës **11'073'400 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **K.M.K**:

Në përgjigje të ofertës anomalisht të ulët, ofertuesi **K.M.K me NIPT L78223801E**, me vlerë të ofertës **11'073'400 lekë**, ka argumentuar vlerën e ofertës anomalisht të ulët, duke dhënë shpjegime dhe analizat teknike të çmimeve për zerat e punimeve. Komisioni i Vleresimit të Ofertave mori në shqyrtim kthimin e përgjigjes, duke argumentuar si më poshtë:

Në zërin e punës An - Shtrese asfaltobeton, me zall lavatriçe 4cm, me makineri, ju i jeni referuar manualit me nr. Analize 3.233/1 dhe keni ardhur me ofertën 704 lekë/m², me zërin material asfaltobeton me çmimin 6300 lekë/T dhe bitum 55 lekë/kg.

Duke e krahasuar me çmimin 1293 lekë/m² të zërit të punës, sipas MANUALIT TEKNIK TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE të miratuar me VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 PËR MIRATIMIN (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (I përditësuar), ju jeni ulur **46.6%**.

Po të marrim në shqyrtim zërin **material asfaltobeton** me çmimin e sjellë nga ju 6300 lekë/T, ku në manual është llogaritur 10242 lekë/T, ulja është **39.8%**. Kurse për **materialin bitum 55 lekë/kg** ju nga manuali jeni ulur **35.5%**.

Në zërin e punës An - Shtrese binderi me zall lavatriçe, 6cm, me makineri, ju i jeni referuar manualit me nr. Analize 3.229/2 dhe keni ardhur me ofertën 703 lekë/m², me zërin material binder me çmimin 4155 lekë/T dhe bitum 55 lekë/kg.

Duke e krahasuar me çmimin 1576 lekë/m² të zërit të punës, sipas MANUALIT TEKNIK TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE të miratuar me VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 PËR MIRATIMIN (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (I përditësuar), ju jeni ulur **66%**.

Po të marrim në shqyrtim zërin **material binder** me çmimin e sjellë nga ju 4155 lekë/T, ku në manual është llogaritur 8695 lekë/T, ulja është **53.3%**. Kurse për **materialin bitum 55 lekë/kg** ju nga manuali jeni ulur **35.5%**.

Për të dy zërat e punës të paraqitura në preventivin e ofertës **ju nuk keni paraqitur kontratat tuaja të furnizimit të lidhura me fabrikat e asfaltobetoneve** për çmimin që ju keni paraqitur në analizat përkatëse dhe të dy këta zëra zënë rreth **72%** të vlerës totale të preventivit të ofertuar, pra ku uljet tuaja janë shumë të konsiderueshme (përkatësisht 46.6% dhe 66%). Prandaj konkludojmë se **materiali i paraqitur - analiza e çmimeve për objektin e procedurës së prokurimit të dërguar nuk merret parasysh.**

Nder të tjera, për kushtet specifike ku çmimet e materialeve janë rritur, dhe sidomos ato të përcaktuara në AKTIN NORMATIV Nr. 10, datë 18.5.2022, hekurit, çimentos, bitumit, aluminit, bakrit dhe zinkut, dhe pikërisht në procedurën tonë materialet çimentos, bitumit janë përbërës kryesor të cilët ndikojnë në vlerën ekonomike të ofertuar.

Nga ana tjetër, për zerat e preventivit 3.158/5a *Transport dheu me auto deri 5.0 km*, dhe 3.212 *Shtrese çakelli t=15cm, makadam, përhapur e ngjeshur makineri*, ju nuk keni sjelle nje analize teknike për argumentimin e ketyre 2 zerave pjesë të preventivit.

- Për ofertuesin **CAUSHI M me NIPT L88419801O**, me vlerë të ofertës **12'244'340 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **CAUSHI M**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g të Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt "FV ndricim rruga "Bajram Tusha" L.14 Shkozë", dhe procedurën me objekt "Rikonstruksion rrugë në Një Katund i Ri".

- Për ofertuesin **S.M.O UNION me NIPT J66902042Q**, me vlerë të ofertës **12'424'300 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, pas verifikimit të dokumentacionit fizik, operatori ekonomik **S.M.O UNION**:

1. Nuk ka paraqitur vertetimin e debisë për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në kundërshtim me nenin 26, pika 6, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si edhe dokumentave standarte të tenderit.

2. Nuk ka paraqitur vertetim që nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së, në kundërshtim me nenin 26, pika 6, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si edhe dokumentave standarte të tenderit.

3. Nuk përmbush piken 2.2.a të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku citohet "*Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore*", pasi nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Mirditë dhe Bashkia Durrës. Nder të tjera, pas verifikimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës, subjekti ofertues rezultoi debitor për vitet 2021 dhe 2022.

4. Nuk përmbush piken 2.3.g të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, pasi për mjetin me targë AA032RI nuk është paraqitur licenca/certifikata e transportit, sipas kërkesave të DST.

- Për ofertuesin **EURONDERTIMI 2000 me NIPT K02003001O**, me vlerë të ofertës **13'169'700 lekë**, me subjekt mbështetës Everest, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **EURONDERTIMI 2000**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g të Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratat me objekt "Loti 1 me objekt: Rikonstruksioni dhe riparimi mjediseve në bashkepronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës, Njesite Adm. nr. 1, 2, 3, 4, 5, Sukth, Manëz", dhe "Riforcimi pallateve me kod gis: 5407, 25387, 26969, 1511, 25947, 26972, 27307, 26764", të cilat janë në proces zbatimi.

2. Ofertuesi EURONDERTIMI 2000 nuk ka deklaruar subjektin mbështetës Everest në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit sipas Shtojcës 8.

- Për ofertuesin **VARAKU E me NIPT J61902509S**, me vlerë të ofertës **13'323'700 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **VARAKU E**:

1. Nuk permbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.g të Kapacitetit Teknik për disponimin punonjesve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjesve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik VARAKU E, janë të angazhuar në kontratat me objekt “Rikonstruksion rruga Dervish Hima”, dhe “Rikonstruksion të rrugëve në qytet”.

- Për ofertuesin **BONUS me NIPT K72412009E**, me vlerë të ofertës **13'336'390 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **BONUS**:

1. Nuk permbush piken 2.3.h të Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Certifikate: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi certifikata e paraqitur me nr. 1710AL592Q rezulton e skaduar në muajin shkurt 2023, fakt i cili vërtetohet edhe në kontrollin në faqen zyrtare të shoqërisë që e ka lëshuar, si edhe barkodit elektronik të certifikatës së paraqitur në SPE, të cilat vërtetojnë statusin “pëzulluar” të certifikatës së mesiperme.

2. Nuk permbush piken 2.3.i të Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Certifikat: ISO 45001:2018 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi certifikata e paraqitur me nr. 1710AL592OHS rezulton e skaduar në muajin shkurt 2023, fakt i cili vërtetohet edhe në kontrollin në faqen zyrtare të shoqërisë që e ka lëshuar, si edhe barkodit elektronik të certifikatës së paraqitur në SPE, të cilat vërtetojnë statusin “pëzulluar” të certifikatës së mesiperme.

- Për ofertuesin **SARK me NIPT K52531415H**, me vlerë të ofertës **13'808'277 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **SARK**:

1. Nuk permbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 32'000'000 lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme*”, pasi referuar dokumentacionit për punët e ngjashme të paraqitura në SPE, nuk plotësohet vlera minimale e kërkuar. Nder të tjera, pjesa me e madhe e kontratave të paraqitura, nuk janë të shoqëruara me formular vlerësimi sipas Shtojcës 9.

- Për ofertuesin **DENIS-05 me NIPT K51518029B**, me vlerë të ofertës **19'052'750 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **DENIS-05**:

1. Ka paraqitur oferte ekonomike me te larte se fondi limit i procedures se prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ASI-2A CO me NIPT K53002402C dhe adresë, Fier Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 14'751'950 (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë, [*Bashkia Durrës, Njësia e Prokurimit, njësia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

11. Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 15'537'600 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Emiriana Sako